



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

2010
Nr. ____ Prot

Vlorë më 29.09.2025

VENDIM

Nr. 16 datë 25.09.2025

PËR MIRATIMIN E AKTIVITETIT “TRASHËGIMIA E GJALLË – MONUMENTET E KULTURËS DHE TË NATYRËS NË QARKUN VLORË SI MOTOR I TURIZMIT TË QËNDRUESHËM, EDUKIMIT KULTUROR DHE PJESËMARRJES KOMUNITARE ” NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT VLORË.

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”; Ligjit 9408, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar; Ligjit “Për buxhetin e vitit 2025”; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr.8 datë 26.03.2024 “Për miratimin e dokumentit strategjik “Vlora 2030” Vendim Nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre” Vendim të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 25, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2025” i ndryshuar, si dhe kërkesës me Nr.1873 Prot datë 15.09.2025 me lëndë: Propozim për zhvillimin e projektit “Trashëgimia e gjallë”.

VENDOS:

1. Të miratohet zëvendësimi i aktivitetit “Colorwave” i parashikuar në buxhetin e Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2025 me aktivitetin “Trashëgimia e Gjallë – Monumentet e Kulturës dhe të Natyrës në Qarkun Vlorë si motor i Turizmit të Qëndrueshëm, Edukimit Kulturor dhe Pjesëmarrjes Komunitare” *pa ndryshime* financiare shtesë sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Për përmbushjen e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikës 3, neni 78 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.



KRYETARI

Ervis MOCKA

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2025

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +35533421608



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

RELACION

Projekti “Trashëgimia e Gjallë – Monumentet e Kulturës dhe të Natyrës në Qarkun Vlorë si motor i turizmit të qëndrueshëm, edukimit kulturor dhe pjesëmarrjes komunitare ”

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”; Ligjin nr.9408, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar; Ligjin “Për buxhetin e vitit 2025”; Vendim Nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre” Vendim të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 25, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2025” i ndryshuar, si dhe kërkesës me Nr.1873 Prot datë 15.09.2025 me lëndë: Propozim për zhvillimin e projektit “Trashëgimia e gjallë”

Përse është përzgjedhur ky projekt?

Qarku i Vlorës numëron mbi 190 monumente të shpallura, që përfshijnë qytete antike, kalatë mesjetare, kisha, ura, shpella me piktura dhe banesa karakteristike. Aktualisht, pjesa më e madhe e vizitorëve e përrjetojnë Vlorën kryesisht si destinacion detar, duke mos shfrytëzuar potencialin e madh kulturor dhe natyror që ky rajon ofron.

Projekti “Trashëgimia e Gjallë” synon të promovojë këto pasuri përmes krijimit të përmbajtjeve multimediale (video, foto, audio-guida, dosje interpretimi), duke i kthyer monumentet në përmbajtje të gjallë edukative dhe turistike. Kjo qasje ndihmon jo vetëm në ruajtjen dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, por edhe në krijimin e identitetit dhe krenarisë kulturore tek brezat e rinj.

Rëndësia dhe ndikimi i projektit

- Nxiti zhvillimin e turizmit kulturor dhe zgjatjen e qëndrimit të vizitorëve në rajon.
- Forcon përfshirjen e komuniteteve lokale, veçanërisht të rinjve, në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë.
- Kontribuon në ruajtjen e elementeve të trashëgimisë jo-materiale (këngë polifonike, gojëdhëna, artizanat).



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

- Krijon një profil më të lartë për Qarkun e Vlorës në hartën kulturore kombëtare dhe europiane.
- Mbështet zhvillimin ekonomik përmes turizmit të qëndrueshëm dhe promovimit ndërkombëtar.

Fazat e projektit

1. Faza e Parë – Kërkimi dhe përzgjedhja e monumenteve
 - Përzgjedhja e 30 monumenteve kryesore, konsultimi me ekspertë dhe komunitete, sigurimi i lejeve për dokumentim.
2. Faza e Dytë – Prodhimi multimedial
 - Realizimi i 30 videove dokumentare, mbi 300 fotografive profesionale, audio-guidave dhe dosjeve të shkurtra shkencore, duke integruar rrëfime lokale dhe elementë të trashëgimisë gojore.
3. Faza e Tretë – Promovimi dhe përfshirja komunitare
 - Organizimi i ekspozitave itinerante, punëtorive edukative në shkolla dhe krijimi i një platforme digjitale interaktive me akses të lirë për publikun.

Përfundim

Projekti “TRASHËGIMIA E GJALLË” ose “Living Heritage Vlora” do të kontribuojë në ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Qarkut të Vlorës, duke e kthyer atë në një motor të zhvillimit turistik, edukativ dhe ekonomik. Zbatimi i tij do të sjellë përfitime afatgjata për komunitetin dhe do të forcojë profilin e Qarkut Vlorë si një qendër kulturore me rëndësi kombëtare.

Për sa më sipër, kërkojmë miratimin tuaj për zëvendësimin e aktivitetit “Colorwave” me projektin “TRASHËGIMIA E GJALLË – Monumentet e Kulturës dhe të Natyrës në Qarkun Vlorë si Motor i Turizmit të Qëndrueshëm, Edukimit Kulturor dhe Pjesëmarrjes Komunitare” pa efekte financiare shtesë në buxhet.

Konceptoi:

Ilda Lamaj

Specialist për Arsimit, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve

Miratoi:

Anisa Hyseni

Drejtor i Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +35533421608